

DEKRET
Nr. 197, datë 8.4.2026

PËR DHËNIE DEKORATE

Në mbështetje të nenit 92, germa “ç”, nenit 93 të Kushtetutës; nenit 6, pika 1, dhe nenit 21, të ligjit nr. 93/2022, “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e dekoratës “Komandar i Urdhrit të Skënderbeut” zotit Frédéric Billet

“Në vlerësim të meritave të dalluara në organizimin e vizitave të nivelit më të lartë shtetëror mes Francës dhe Shqipërisë, si dhe të lehtësive që u ka krijuar, në aspektet protokollare dhe organizative, ndërveprimeve diplomatike, duke kontribuar në forcimin e marrëdhënieve mes dy vendeve tona”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj